

Voith Hydro GmbH&Co.KG - Degë e Shoqërisë së Huaj-Tirane

Pasqyrat Financiare për periudhën nga 10 Maj 2018 deri më 31 dhjetor 2018

W

PERMBAJTJA

	Faqe
Pasqyra e pozicionit financiar për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2018	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2018	2
Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	3
Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	4
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	5-11



Voith Hydro GmbH&Co.KG – Degë e Shoqërisë së Huaj
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018
(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Shënimi

31 Dhjetor 2018

Aktive

Aktivet afatshkurtra

Mjete monetare dhe ekuivalentë	5	7,449,818
Parapagime dhe të arkëtueshme të tjera	6	13,066,937
Totali i aktiveve afatshkurtra		20,516,755
Totali i aktiveve		20,516,755

Kapitali

Humbja/Fitimi i periudhës	15	5,925,151
Totali i kapitalit		5,925,151

Detyrimet

Detyrimet afatshkurtra

Llogari të pagueshme	7	8,791,600
Detyrim ndaj palëve të lidhura	8	4,754,229
Parapagime dhe detyrime të tjera	9	1,045,776
Totali i detyrimeve afatshkurtra		14,591,604
Totali i detyrimeve		14,591,604
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		20,516,755

Pasqyra e pozicionit financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-11 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Josef Krausgruber

Administrator



Voith Hydro GmbH&Co.KG – Degë e Shoqërisë së Huaj
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera përbledhëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënim	31 Dhjetor 2018
Te ardhurat	10	65,420,154
Shpenzime për sherbime	11	(56,923,348)
Shpenzime personeli	12	(155,223)
Shpenzime të tjera	13	(218,653)
Rezultati i veprimtarise se shfrytezimit		8,122,931
		<hr/>
Të ardhura financiare	14	148,408
Shpenzime financiare	14	(1,300,497)
Kosto financiare, neto		(1,152,089)
		<hr/>
Humbja para tatimit	15	(6,970,842)
Shpenzimi mbi tatim fitimin		<hr/> (1,045,691)
Fitim/Humbja pas tatimit		<hr/> 5,925,151
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		<hr/> -
Fitim/Humbja gjithëpërfshirëse për vitin		<hr/> 5,925,151

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera përbledhëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-11 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



W

Voith Hydo GmbH&Co.KG – Degë e Shoqërisë së Huaj
Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Shënim
31 dhjetor 2018

Flukset monetare nga aktivitetet operative:

Humbja neto përpara tatimit	6,970,842
-----------------------------	-----------

Rregullimet për:

Shpenzime të tatimit mbi fitimin	(1,045,691)
Fitim/Humbja operative përpara ndryshimeve në kapitalin	5,925,151

Rritje në të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	(13,066,937)
--	--------------

Rritje në llogari të pagueshme tregtare	4,754,229
---	-----------

Rritje në llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	8,791,600
---	-----------

Rritje në parapagime dhe në detyrime të tjera	1,045,776
---	-----------

Flukset monetare nga aktivitetet operative	7,449,818
---	------------------

Tatim fitimi i paguar	-
-----------------------	---

Flukset monetare neto nga aktivitetet operative	7,449,818
--	------------------

Flukset monetare nga aktivitetet investuese	-
--	---

Mjetet monetare neto përdorur në veprimtaritë investuese	-
--	---

Flukset monetare nga aktivitetet financuese	-
--	---

Flukset monetare neto gjeneruar nga aktivitetet financuese	-
---	---

Rritja neto e mjeteve monetare dhe ekuivalente	7,449,818
--	-----------

Mjete monetare dhe ekuivalente më 10 Maj 2018	-
---	---

Mjete monetare dhe ekuivalente më 31 dhjetor 2018	7,449,818
--	------------------

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare dhe ekuivalentë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 - 11 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Voith Hydro GmbH&Co.KG – Degë e Shoqërisë së Huaj
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018
(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Fitimi për periudhën	Totali
Gjëndja më 10 Maj 2018	-	-
Fitimi për periudhën	5,925,151	5,925,151
Pozicioni më 31 dhjetor 2018	5,925,151	5,925,151

Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 - 11 që janë pjesë përbërëse e pasyrave financiare.

Voith Hydro GmbH&Co.KG – Degë e Shoqërisë së Huaj
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

1. Informacione të përgjithshme

Voith Hydro GmbH&Co.KG – Degë e Shoqërise së Huaj (këtu më poshtë referuar si "Dega") është themeluar në Shqipëri më 10 Maj 2018. Shoqëria është degë e shoqërisë së huaj Voith Hydro GmbH &CO KG e inkorporuar sipas ligjeve të Austrisë dhe vendi kryesor i biznesit është Linzer Strasse 55, A-3100 Polten, Austri (këtu më poshtë referuar si "Shoqëria Mëmë").

Dega është themeluar në Shqipëri për ekzekutimin e marrëveshjes midis Korporatës Elektroenergitike Shqiptare sh.a, (këtu më poshtë referuar si "Kurum shpk") një shoqëri e inkorporuar sipas ligjeve të Shqipërisë dhe me adresë në Ish Kombinati Metalurgjik Elbasan, Shqipëri dhe Shoqërisë Mëmë Voith Hydro GmbH&Co.KG për të kryer punime dhe shërbime që lidhen me e rehabilitimit të hidrocentralit të ULZES

Dega është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) më 10 Maj 2018, me NIPT L81710023P dhe për qëllime tatumore aktualisht është nën administrimin e Drejtorisë Rajonale Tatumore Tiranë.

Adresa e regjistruar e Degës është: Rr. "Ismal Qemali", Samos Tower, Kat 8, Apartamenti 41, Tiranë.

Dega ka 3 punonjës më 31 dhjetor 2018.

Bazuar në legjislacionin shqiptar, dega e kompanisë së huaj nuk kërkonhet të kontribuojë në kapital.

2. Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë.

3. Përbledhje e politikave të konsiderueshme kontabël

Politikat kryesore kontabël të përdorura në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë përcaktuar si më poshtë. Këto politika janë aplikuar në mënyrë konsistente, nëse nuk është specifikuar ndryshe.

3.1 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në përpunje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK). Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike.

3.2 Standardet e reja dhe interpretimet

Një numër standardesh të reja, si dhe ndryshime të standardeve dhe interpretimeve janë efektive për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018. Asnjë nga këto nuk pritet të ketë një efekt të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Gjithashtu një numër i standardeve të reja dhe ndryshimeve të standardeve dhe interpretimeve nuk janë ende në fuqi për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Asnjë nga këto nuk pritet të ketë një efekt të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

3.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lekë, që është dhe monedha funksionale e Republikës së Shqipërisë dhe monedha funksionale dhe e paraqitjes së Degës.

3.4 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zërat monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhë të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbëhen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Voith Hydo GmbH&Co.KG – Degë e Shoqërisë së Huaj
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Kursi i këmbimit të lekut për 1 njësi të monedhës së huaj në datën e raportimit është paraqitur më poshtë:

2018

Kursi i fund vitiit Lekë / Euro	123.42
---------------------------------	--------

3.5 Instrumentet financiare

Instrumentet financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare e të tjera ekuivalente dhe llogari të pagueshme. Gjatë periudhave të raportuara nuk ka pasur investime në kapital apo në letra me vlerë.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë duke shtuar, për instrumentat e mbajtur jo me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, çdo kosto transaksiioni që lidhet me to, përvèç siç përshkruhet më poshtë. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument finanziar njihet nëse Dega bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit finanziar ose kur Dega transferon aktivin finanziar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Dega angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare c'regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

a. Instrumentet financiare

Mjetet monetare dhe ekvivalentë

Mjetet monetare dhe ekvivalentë përfshijnë llogaritë rrjedhëse bankare që kanë një maturitet më pak se 3 muaj. Mjetet monetare dhe ekvivalentë njihen në fillim me vlerën e drejtë dhe më pas maten me kosto të amortizuar.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme janë shpërndarë në kategorinë e të arkëtueshmeve si dhe njihen fillimisht me vlerën e drejtë e më pas maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv e duke i zbritur humbjet nga zhvlerësimi.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke u bazuar në metodën e interesit efektiv.

Të tjera

Instrumenta të tjera jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga rënie në vlerë.

b. Zhvlerësimi

(i) Aktivet financiare

Një aktiv finanziar konsiderohet i i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme të parashikuara të aktivit. Një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me aktivin finanziar të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë, të skontuara me normën fillestare efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme individualisht, testohen për rënie në vlerë në mënyrë individuale. Aktivet e tjera të mbetur financiare vlerësohen kolektivisht, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

**Voith Hydro GmbH&Co.KG – Degë e Shoqërisë së Huaj
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitime ose humbje. Një humbje nga zhvlerësimi anullohet nëse anullimi mund të lidhet me një ngjarje të ndodhur pas njoftes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivin financiar të matur në kosto amortizimi, anullimi njihet në humbje ose fitim.

(ii) Aktivet jo financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të Degës rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktiv apo shuma e parave që ai gjeneron tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitime ose humbje.

c. Njoftja e të ardhurave

Të ardhurat janë fluksi i përfitimeve ekonomike bruto gjatë periudhës që gjenerohen gjatë aktivitetit të zakonshëm të Degës.

d. Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesit nga llogaritë në banka dhe fitime nga kursi i këmbimit. Të ardhurat nga interesit njihen mbi baza konstatimi duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesit nga llogaritë në banka, humbjet nga kursi i këmbimit dhe humbjet nga zhvlerësimi të njoftura në aktivet financiare. Kostot e huamarjes njihen në fitime ose humbje me metodën e interesit efektiv.

e. Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet drejtëpërdrejt në fitime ose humbje përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatushme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuarë në datën e raportimit, dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm nga vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet mbi diferençat e përkohshme midis vlerës së mbetur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime tatimi. Tatimi i shtyrë llogaritet me normat e tatimit që priten të aplikohen mbi diferençat e përkohshme në periudhën kur ato rimerren, bazuar në legjislatacionin në fuqi deri në datën e raportimit.

Dega njeh një aktiv tatimor të shtyrë mbi humbjet tatimore të mbartura në masën që është e mundur që këto humbje mund të përdoren kundrejt një fitimi të tatushëm të ardhshëm.

3.6 Vlerësimet dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin, vlerësimet dhe supozimet e tyre që ndikojnë në procesin e zbatimit të politikave kontabël të njësisë raportuese dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njoftura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacioni mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve, pasigurive dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njoftura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Dega.



Voith Hydo GmbH&Co.KG – Degë e Shoqërisë së Huaj
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

4. Menaxhimi i riskut financiar

Vështrim i përgjithshëm

Dega është e ekspozuar ndaj risqeve të mëposhtme në përdorimin e instrumenteve financiarë:

- Risku i kredisë
- Risku i likuiditetit
- Risku i tregut

Në këtë shënim jepet informacion mbi ekspozimin e Degës ndaj secilit prej risqeve të mësipërme, objektivat e Degës, politikat dhe procedurat për të matur dhe menaxhuar këtë risk, si dhe menaxhimin e kapitalit. Shpjegime të mëtejshme sasiore janë përfshirë në këto pasqyra.

Drejtimi dhe shoqëria mëmë kanë përgjegjësinë e përgjithshme për vendosjen e një kuadri të posaçëm për mbikëqyrjen dhe menaxhimin e riskut për Shoqërinë.

Politikat e menaxhimit të riskut përcaktohen për të identifikuar dhe analizuar riskun ndaj të cilil ekspozohet Dega, për të përcaktuar kufijtë e riskut dhe kontrollit, si dhe për të monitoruar riskun.

a. Risku i kredisë

Risku i kredisë është rishku i humbjes financiare të shkaktuar nga dështimi i palës tjeter për të shlyer detyrimet e saj financiare kundrejt Degës dhe vjen kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të Degës. Dega e gjykon riskun e kredisë minimal për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018.

b. Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është rishku që Dega mund të ketë vështirësi në krijimin e fondeve për t'u përgjigjur angazhimeve financiare në lidhje me instrumentet financiare. Metoda e Degës për menaxhimin e likuiditeteve është të sigurojë sa më shumë të jetë e mundur likuiditeti për të përbushur detyrimet në kohë dhe në kushte normale dhe jo-normale pa pasur humbje të papranchesme ose pa rrezikuar dëmtim të reputacionit të saj. Tabela më poshtë analizon aktivet dhe detyrimet financiare monetare të Degës sipas kohëzgjatjeve përkatëse bazuar në periudhën e mbetur nga data e raportimit deri në datën e maturimit kontraktual.

31 Dhjetor 2018	Më pak se 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 muaj deri në 1 vit	Më shumë se 1 vit	Totali
Aktivet financiare					
Llogari të arkëtueshme (shënim 6)	32,611,198	-	-	-	32,611,198
Mjete monetare dhe të tjera ekivalente (shënim 5)	7,449,818	-	-	-	7,449,818
Totali	40,061,198	-	-	-	40,061,198
Detyrimet financiare					
Llogari të pagueshme (shënim 7)	- (8,791,600)			-	(8,791,600)
Detyrime ndaj palëve të lidhura (shënim 8)	-	- (24,298,672)		-	(24,298,672)
Të tjera të pagueshme (shënim 9)	(1,045,776)	-		-	(1,045,776)
Totali	-	-	(24,298,672)	-	(24,298,672)
Risku i likuiditetit më 31 Dhjetor 2017	(1,045,776)	(8,791,600)	(24,298,672)	-	(34,136,047)

c. Risku i tregut

Risku i tregut është rishku që ndryshimet në çmimet e mallrave si kurset e këmbimit, normat e interesit dhe çmimet e kapitalit të ndikojnë në të ardhurat e Degës ose vlerën e instrumenteve financiare që ajo disponon. Qëllimi i menaxhimit të riskut të tregut është të menaxhohen dhe kontrollohen ndaj risqeve të tregut brenda parametrave të pranueshëm duke optimizuar fitimin. Drejtimi ka krijuar derivativë për mbrojtjen nga ky risk.

U

Voith Hydro GmbH&Co.KG – Degë e Shoqërisë së Huaj
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)
i. Risku i kurseve të këmbimit

Risku i kurseve të këmbimit lind kur transaksione të ardhshme tregatare ose aktive ose detyrime të njohura shprehen në një monedhë e cila nuk është monedha funksionale e Degës. Eksposimi i Degës ndaj riskut të kursit të këmbimit paraqitet në vijim. Shumat e treguara priten të arkëtohen dhe paguhen në Euro dhe Lekë:

31 Dhjetor 2018	Euro	Lekë	Vlerë kontabël
Aktive financiare			
Llogari te arkëtueshme (shënim 6)	32,611,380		32,611,380
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente (shënim 5)	7,328,385	121,434	7,449,818
Totali	39,939,765	121,434	40,061,199
Detyrime financiare			
Llogari të pagueshme (shënim 8)	(8,791,600)		(8,791,600)
Detyrime ndaj palëve të lidhura (shënim 9)	(24,298,672)		(24,298,672)
Të tjera të pagueshme (shënim 9)		(1,045,776)	(1,045,776)
Totali	(33,090,271)	(1,045,776)	(34,136,047)
Risku i kurseve të këmbimit më 31 Dhjetor 2018	(33,090,271)	(1,045,776)	(34,136,047)

ii. Risku i normës së interesit

Dega përballet me një risk jo të rëndësishëm të normës së interest për shkak se ajo nuk ka detyrime financiare që mbartin interes.

5. Mjete monetare dhe ekvivalentë

Mjete monetare dhe ekvivalentë më 31 dhjetor 2018 përbëhen nga si më poshtë:

	31 Dhjetor 2018
Llogari rrjedhëse me bankat:	
Në Lekë	121,434
Në Euro	7,328,385
Totali	7,449,818

Gjendja e mjeteve monetare në bankë më 31 dhjetor 2018 përbëhet nga llogari rrjedhëse të mbajtura pranë Raiffeisen Bank në Shqipëri.

6. Llogari të tjera të arkëtueshme dhe parapagime

Parapagimet dhe të tjera të arkëtueshme më 31 Dhjetor 2018 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2018
Te arketueshme nga Kurum shpk	12,942,809
TVSH e zbritshme	124,128
Totali	13,066,937

4

Voith Hydro GmbH&Co.KG – Degë e Shoqërisë së Huaj
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

7. Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2018 janë të përbëra si më poshtë:

	31 Dhjetor 2018
Të pagueshme ndaj furnitorëve	8,791,600
Totali	8,791,600

Të pagueshme ndaj furnitorëve më 31 dhjetor 2018 lidhet kryesisht me shërbimet e nënkontraktorëve dhe drejtuesit teknik.

8. Kundrejt palëve të lidhura

Tabela e mëposhtme paraqet llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2018:

	31 Dhjetor 2018
Të pagueshme ndaj Voith Hydro GmbH&Co.KG	4,754,229
Totali	4,754,229

Të pagueshmet lidhen me detyrimet kundrejt shoqërisë mëmë Voith Hydro për pagesat e bëra nga kjo e fundit për mbështetjen e aktivitetit të Degës në Shqipëri.

9. Parapagime dhe detyrime tatimore

	31 dhjetor 2018
Tatim fitimi per tu paguar	1,025,691
Kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	20,085
Totali	1,045,776

10. Të ardhurat

	31 dhjetor 2018
Të ardhura nga aktiviteti	65,420,154
Totali	65,420,154

11. Furnizimet dhe shërbimet

Shërbimet dhe furnizimet deri më 31 dhjetor 2018 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2018
Sherbime teknike	55,848,217
Shërbime fiskale dhe kontabël	1,066,731
Shërbime përkthimi dhe notariale	8,400
Totali	56,923,348



Voith Hydro GmbH&Co.KG – Degë e Shoqërisë së Huaj
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

12. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2018 janë **155,223** lekë dhe përbëhen nga sigurimet shqërore dhe shëndetësore të paguara nga administratorët e Degës gjatë vitit 2018.

13. Shpenzime të tjera

Shpenzimet e tjera përbëhen si me poshtë:

	31 Dhjetor 2018
Taksa bashkiakë	131,333
Komisione bankare	86,888
Penalitete/kamatvonesë	431
Totali	218,653

14. Humbja financiare

Rezultati finansiar neto më 31 dhjetor 2018 përbëhet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2018
Fitime të parealizuara nga këmbimet valutore	-
Fitime të realizuara nga këmbimet valutore	148,408
Totali i fitimeve financiare	148,408
Humbje të parealizuara nga këmbimet valutore	(1,300,497)
Humbje të realizuara nga këmbimet valutore	(1,300,497)
Humbja totale financiare	(1,152,089)

15. Tatimi mbi fitimin

Në përputhje me legjislacionin tatimore shqiptar, norma e aplikueshme e tatim-fitimit për vitin 2018 është 15%. Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen si vetëdeklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Për periudhën deri më 31 Dhjetor 2018, Dega rezulton me pagesë tatim fitimi prej 1,045,691 Lekë.

Shpenzime për tatim mbi fitimin	Shkalla tatimore efektive	31 dhjetor 2018
Fitimi para tatimit		6,970,842
Shpenzime të pazbritishme	15.00%	431
Shpenzime tatim fitimi 15%		1,045,691
<i>Shpenzime të pazbritishme të tjera</i>	0.00%	-
<i>Keste tatim fitimi</i>		(20,000)
Humbje fiskale	(15.00%)	
Total	0.00%	1,025,691

16. Angazhime dhe pasiguri

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Dega nuk përfshihet në pretendime apo veprime ligjore.

17. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka asnjë ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.



